



UNIVERSITETI I SHKODRES

“Luigj Gurakuqi”

Nr. 3217 Prot.

Shkodër, më 17.10. 2017

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” shpallet konkursi për një vend të lirë pune në **Fakultetin e Shkencave të Edukimit**, Departamenti i Psikologjisë dhe punës sociale, për pozicionin as/lektor/e me kohë të plotë për lëndët “Psikologji ligjore” dhe “Psikologji shëndeti” në programet e studimit bachelor në “Psikologji” dhe “Punë sociale”.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere specifike :

- Të jenë diplomuar në të gjitha nivelet në fushën e psikologjisë, në sistemin me kohë të plotë.
- Të kenë kryer shkollën pasuniversitare me diplomë “Master Shkencor” në fushën e psikologjisë ose gjatë studimeve universitare dhe pasuniversitare të kenë grumbulluar jo më pak se 300 kredite në fushën e psikologjisë, me notë mesatare jo më të ulët se 9. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga MASR.
- Të kenë kryer arsimin e lartë në sistemin me kohë të plotë, në degën “Psikologji” me notë mbi 8.5.
- Nota mesatare e përgjithshme e studimeve në diplomën e sistemit të vjetër/DND të jetë mbi 8.5.
- Të kenë notën mesatare të grup-lëndëve, për të cilat konkurohet jo më pak se 9.
- Të ketë përfunduar studimet “MSH” në fushën e psikologjisë me kohë të plotë, me notë mesatare jo më të ulët se 9.
- Të njohë një gjuhë të huaj perëndimore (preferohet anglisht) me notë jo më të ulët se 8 ose të ketë mbrojtur një nga pesë gjuhët e njohura nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për gjuhët në nivelin C1.
- Të kenë dhënë provim universitar dhe/ose pasuniversitar lëndën për të cilën pretendojnë të jenë as/lektorë me notë 9.
- Preferohen që kandidatët të kenë:
 1. titull akademik ose gradën shkencore “Doktor”,
 2. eksperiencë pune në mësimdhënie në shkollën e lartë, në lëndët që konkuron,
 3. të kene aktivitet botues,
 4. të kenë eksperiencë pune mbi dy vjet në profilin përkatës,
- Shtetasit e huaj duhet të kenë leje pune dhe leje qëndrimi.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme :

- Të kenë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojnë aftësi profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
- Të kenë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit profesional.
- Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale.
- Të mos jenë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
- Të mos kenë kryer krime të parashikuara nga kodi penal i Republikës së Shqipërisë.
- Të mos jenë larguar nga USH pa miratimin e këtij të fundit.
- Të mos kenë lidhje **familjare** (bashkëshort/bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), **gjinie** (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj) apo **krushqie** (prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve) me punonjës ekzistues brenda njësisë bazë apo ndihmëse ku kërkohet të punësohen.
- Të mos kenë prishur në mënyrë publike imazhin e USH.

Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente :

1. Të aplikojë "on-line" në faqen zyrtare të USH në internet në adresën : www.unishk.edu.al. (rubrika punësime).
2. Jetëshkrim (CV) me foto personale dhe letërmotivimi.
3. Dëshmi MND ose DND dhe e provimeve pasuniversitare (lista e notave e noterizuar) të njohura zyrtarisht. Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MASR.
4. Diplomë të Shkollës së Lartë ose fotokopje dhe lista e notave (të noterizuara).
5. Dy rekomandime nga mësimdhënës me tituj shkencorë në profilin për të cilin konkurohet.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore, ose fotokopje e noterizuar.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, workshope etj.
9. Dëshmi e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) dhe mjekësore (kartë shëndeti+librezë shëndetsore).
10. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon dhe/ose vërtetim papunësie nga Zyra e Punës.
11. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 8 të Rregullores së posaçme të Universitetit për Zënien dhe Ruajtjen e vendit të punës (për moslidhje farefisnore).
12. Çertifikatë familjare dhe dokument identifikimi vetjak (fotokopje pasaporte, letërnjoftimi ID).
13. Listë përmbledhëse e dokumenteve të dorëzuara nga konkurenti.
14. Çdo dokument tjetër që vërteton kërkesat e mësipërme.

Shënim:

- *Kontrata e punës do të jetë me afat 1 – vjeçar (vit akademik) me të drejtë rinovimi.*
- *Kandidatët duhet të bëjnë aplikimin "on-line" dhe të dorëzojnë pranë Degës së Burimeve Njerëzore ose Sektorit të Protokoll-arkivës dokumentacionin e mësipërm deri më datë 04.11.2017.*
- *Konkursi do të zhvillohet me datë 06.11.2017, me dosje dhe/ose testim dhe/ose intervistë, sipas orarit që do të përcaktojë komisioni Ad-hoc i ngritur pranë Departamentit të Psikologjisë dhe punës sociale.*
- *Kandidatët që kualifikohen do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc deri më 11.11.2017.*
- *Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit dhe ora e saktë, t'i drejtoheni Dekanatit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe/ose Degës së Burimeve Njerëzore.*

Rektori i Universitetit të Shkodrës

"Luigj Gurakuqi"

